

# ZËRI I POPULLIT



# ZËRI I SË ARDHMES

## TË LUMTUR UDHËHEQIM

BEHAR (13), ISUF (13), ANDUELA (13), ALTINA (13), VALON (14), FATLUM (14), DION (13)



**Demokracia ka elementet e saja. Këto elemente duhet përdorur çdo ditë. Mësojeni cilat janë ato**

Në shkollën tonë shpesh zhvillohen lojëra të ndryshme sportive. Prandaj, së fundi ne kishim edhe një turnir. Për të gjithë nxënësit e shkollës, turniret e futbollit janë jashtëzakonisht të rëndësishme. Në njërin nga turniret, klasa jonë kishte arritur të shkonte deri në finale. Gjatë lojës, papritur një lojtar i ekipit tjetër



më lëndoi. Shokët e mi reagueshan me ashpërsi dhe për pak sa nuk filluan konfliktin. Megjithatë, unë ndërhyra dhe thashë se nuk duhet të silllemi në këtë mënyrë me njëri-tjetrin. U tregova se duhet të jemi të respektueshëm, sepse kështu e do demokracia. Shokët e mi u bindën dhe thanë se vërtet duhet treguar paqësor, sepse jemi qytetarë demokratikë. Lexues të dashur, vepra të tilla të vogla janë të mëdha në demokraci. Nëse secili nga ne i respekton elementet e demo-



kracisë që janë: paqja, toleranca, respekti, liria, etj., atëherë ne do të ndërtojmë një demokraci të qëndrueshme. Po, ç'është demokracia? Demokracia është dhurata më e bukur që kemi. Falë saj, ne qytetarët jemi pjesë e vendimmarrjes. Demokraci do të thotë udhëheqje e popullit. Andaj, të udhëheqim ashtu si na ka hije. Me dinjitet dhe me respekt për njëri-tjetrin.



Gazetarët e demokracisë

# QYTETARIA AKTIVE E NDËRTON DEMOKRACINË

ALBINA (13), RREZARTA (13), ELJESA (13), NJOMZA (131), YLLDAN (13), AID (13), ARDIT (14)



**Ndoshta të gjithë e dijmë se demokracia është një fjalë që rrjedh nga gjuha greke që i bie qeverisje e popullit. Por, a e dijmë të gjithë se si ne duhet të kontribuojmë në zhvillimin e saj?**

Këtë ua themi ne, sepse e kemi provuar se si është të tregohemi qytetarë aktiv në shtetin demokratik.

Secili qytetar mund të kontribuoj në shtetin e tij pavarësisht se në bazë të të cilit sistem jeton ai shtet.



Unë kam ide të ndryshme për të qenë qytetare aktive

Kjo nënkupton se roli i qytetarëve është i jashtëzakonshëm në ndërtimin dhe zhvillimin e shtetit. Por, qasja më e lehtë për të dhënë kontribut ne besojmë se është në shtetet demokratike. Kjo për arsye se sistemi demokratik karakterizohet me shprehje të lirë të mendimit, pjesëmarrje të popullit dhe vetëiniciativë. Tërë këto karakteristika, ndikojnë që qytetarët të jenë të motivuar edhe më shumë që të jenë qytetarë aktiv dhe ta përmirësojnë jetën në komunitet. Edhe ne, si



nxënës kemi pasur rastin të jemi qytetarë aktiv. Kjo ka rrjedhur nga fakti se në demokraci të gjithë mund të japim ide të ndryshme. Ideja që ne kemi dhënë ishte shumë efektive. Kjo ide, kishte të bënte me ndihmën që u kemi ofruar nxënësve të cilët nuk i kishin të mira kushtet ekonomike. Ne së bashku me nxënësit e tjerë, kemi përgatitur ushqime të llojllojshme dhe i kemi shitur ato. Të hollat që i kemi fituar, i kemi dërguar tek familjet e tyre dhe kështu kemi ndikuar që ato familje të ndahen të kënaqura me iniciativën tonë. Kemi pasur edhe shumë raste të tjera ku kemi qenë qytetarë aktiv dhe kemi vërejtur se të qenurit aktiv, nuk ndikon vetëm në nivel individual, por edhe në nivel grupor. Kjo i bie se përfshirja e qytetarëve në iniciativa të ndryshme me karakter pozitiv e përmirëson dukshëm jetën e tërë komunitetit dhe zhvillimin e demokracisë. Prandaj, qytetarë të dashur mos e lër pas kontributin që mund ta ofroni në shtetin tuaj. Idetë tuaja kanë vlerë.



Jemi qytetarë aktiv, sepse e duam shtetin tonë

# ZGJEDHJET JANË ÇELËSI I SË ARDHMES

EDONA (13), GENTA (13), BLEON (13), ARBRIM (13), ENSAR (13), MEDINA (14)



**Ne e dijmë se ju keni dëgjuar për zgjedhjet, por nuk besojmë se keni dëgjuar se cilat janë mendimet e fëmijëve për këtë proces kaq të rëndësishëm. Nëse doni të dini këtë gjë, atëherë lexojeni këtë artikull**

Këtë artikull vendosëm ta fillojmë duke treguar se çfarë janë zgjedhjet. Kur isha e vogël e dëgjoja nënën duke i thënë babait: „Sot është dita e zgjedhjeve!“ Por unë nuk e dija se ç’po thonin. Prandaj, e pyeta nënën:



**Këta janë piktorët e artikullit për Zgjedhjet**

„Çfarë janë këto zgjedhje?“ Nëna filloi të më tregojë: „Shiko bijë, kjo është një punë për të rriturit, por është mirë ta mësosh edhe ti. Pasi që jetojmë në Kosovë, duhet të bëjmë disa zgjedhje. Ne duhet ta votojmë një person i cili duhet ta udhëheq Kosovën, një person i cili duhet të kujdeset për ne, për të varfërit dhe të na plotësojë të gjitha gjërat që neve na nevojiten, si: ndonjë park, ndonjë bibliotekë, apo diçka tjetër.“ Por, në lagjen time unë nuk kisha një park për të lu-

ajtur. „Dua një park“ i thashë nënës dhe dua të votoj edhe unë. Nëna më tha: „Ah, por ti nuk mundesh, sepse je ende e vogël. Kur t’i mbushësh 18 vjet do të vish dhe do të votosh.“ Unë i thashë nënës: „Atëherë kur unë të rritem dhe kur nuk do të më pëlqej të luaj më, do të dal të votojë. Për shkak se ende nuk kam arritur moshën e duhur, do të bëj ashtu si të thuash ti nënë. Kështu thotë ligji dhe ne duhet ta dëgjojmë dhe ta respektojmë atë.“

Edhe pse jemi ende fëmijë, ndoshta neve na ka rënë rasti të jemi pjesë e votimeve. Mua më ka ndodhur një gjë e tillë: Unë me familjen time ishim në shtëpi duke qëndruar dhe vendosëm ta vizitojmë një familjarë tonin. Nuk e dinim se te kush të bënim vizitë. Babait pak çaste më vonë i erdhi në mendje një ide. Ai na tha të bënim një lloj zgjedhjesh. Ne duhej të votonim. Ashtu edhe bëmë. Pas votave, vendosëm të vizitonim hallën. Nga kjo kuptova në një farë mënyre se çfarë janë votimet.



**Kurse, këto janë shkrimtarët e këtij artikulli**

## TRI DEGËT E PUSHTETIT

RINOR (13), GENTRIT (13), RINESA (13), VALENTINA (13), BEDRIE (14), ARJANIT (14)



Çdo shtet demokratik duhet të ketë Ndarje të Pushtetit



KUVENDI

**Sot shoqja jonë Bedrija, e pati rastin të shikonte në përmbajtjen e Kushtetutës së Kosovës. Pasi lexoi disa nga nenet e saj, ajo filloi të na komentoj sipas saj, se cilët nga nenet e Kushtetutës janë më të rëndësishmet. Filloi me nenin 3, nenin 15, nenin 25, etj. Të gjitha këto nene kishin të bënin me të drejtat e qytetarëve dhe se si të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit. Por, një nen që ajo e diskutoi më gjatë ishte neni 4**

Tung, tung, të dashur bashkëmoshatarë. Jam unë Arjaniti, i cili sot do t'i transmetojë shumë gjëra që grupi ynë diskutoj rreth Ndarjes së Pushtetit. Ndërsa, shokët dhe shoqet e mia, do t'iu informojnë përmes vizatimeve të tyre, se si ndahet pushteti në demokraci.

Pushtetit ndryshe mund t'i referohemi si fuqi për të vepruar. E këtë fuqi në vendin tonë, përpos që e gëzojnë qytetarët, e gëzojnë edhe institucionet. Në fakt, këto të fundit, fuqinë për të vepruar e fitojnë nga populli. Si për shembull, fuqia e Kuvendit vjen nga populli në njërën anë dhe nga Kushtetuta në anën tjetër. Sepse, Kushtetuta e ka paraparë që Kuvendi (deputetët) të zgjedhen direkt nga populli. Ky i fundit, fuqin

e vetë e delegon tek deputetët. Është edhe Qeveria, ajo e cila ka rol të rëndësishëm në jetën tonë. Bile mund të themi afërsisht të njëjtë me Kuvendin. Po të mos ishte Qeveria, jeta jonë dukshëm do të ishte më ndryshe, sepse ligjet që propozohen nga ky institucion na lehtësojnë jetën tonë dhe na bëjnë më të lumtur. Por, nganjëherë jo të gjithë qytetarët i zbatojnë dhe i respektojnë ligjet. E për të gjithë ata që veprojnë në kundërshtim me ligjin, është Gjykata ajo që merret me ta. Në Kosovë, kemi Gjykatën Themelore, të Apelit dhe atë Supreme. Siç po e shihni, prania e këtyre institucioneve në jetën tonë, qenka shumë e rëndësishme dhe e nevojshme.



Ne sot ishim mysafir të projektit Demos-ti

Kushtetuta e Kosovës përbëhet gjithsej nga 162 nene. Neni 162 tregon se kur ka hyrë në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës. E unë Bedrija, dua t'iu tregoj se prej neni 1 e deri tek neni 162, që të gjithë kanë rëndësi shumë të madhe. Por, unë dua të veçoj nenin 4, ku flitet për Ndarjen e Pushtetit. Pushteti sipas Kushtetutës ndahet në degën e Legjislativitet që ushtrohet prej Kuvendit, Ekzekutivitet që ushtrohet prej Qeverisë dhe Gjyqësorit që ushtrohet prej Gjykatës. Që të gjithë këto duhet të funksionojnë në mënyrë të ndarë nga njëra-tjetra, në mënyrë që të gjithë qytetarët, duke përfshirë këtu edhe ne, të jenë të lumtur dhe të jetojnë në harmoni.



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Hitmi Rakovica“  
Klasa: VIII-4  
Vendi: Prishtinë